



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 481/Prot.
2

Tiranë, më 14.02.2023

VENDIM

Nr. 7, datë 14.02.2023

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT
TË BRENDSHËM 2022, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË ”**

Në bazë të nenit nr. 49 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të neneve 51 (shkronja m) dhe 53 (pika 2) të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të Rregullores së UMT-së dhe Rregullores së Bordit të Administrimit; të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar si dhe të Standardeve të Auditimit të Brendshëm; të shkresës me nr. 465 prot., datë 13.02.2023 “Dërgimi i Raportit të Veprimitarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022” të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 14.02.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Raportin e Veprimitarisë së Auditimit të Brendshëm në UMT, për vitin 2022” si dhe Pyetësin e Vetëvlerësimit dhe Pasqyrat shoqëruese, (bashkëlidhur këtij Vendimi).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Përgjegjësi dhe Struktura e Njesisë së Auditimit të UMT-së .
3. Ky vendim i përcillet për njohje Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË
VERA OSTRENI ALTINA XHAFERI**

MONIKA FIDA

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM



**RAPORT VJETOR I
VEPRIMTARISË
TË
AUDITIMIT TË BRENDSHËM
2022**

PERMBAJTJA

I. Përmbledhje ekzekutive	4
II. Baza ligjore dhe rregullatore për Auditimin e Brendshëm.	6
III. Organizimi	9
IV. Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm	13
V. Rekomandimet	17
VI. Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë	18
VII. Analiza e kapaciteteve Audituese	19
VIII. Konkluzione	20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORTI VJETOR 2022
I
VEPRIMTARISË SË NJËSISË SË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM
NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Miratuar me Vendim Nr.7, datë 14.02.2023
të Bordit të Administrimit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në zbatim të pikës ç të nenit 14 të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik”, Manuali për Auditimin e Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.3 dhe Kartës së Auditimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, ju paraqet raportin vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2022.

Në funksion të përmbushjes së misionit, në zbatim të planit vjetor, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese gjatë vitit 2022 kanë qenë vlerësimi i sistemeve me risk të lartë me qëllim që :

Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMT, të japë siguri të arsyeshme Bordit të Administrimit mbi:

- ✓ *Efektivitetin , eficencën dhe economicitetin e përdorimit të burimeve;*
- ✓ *Përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi;*
- ✓ *Besueshmërinë dhe integritetin e Informacioneve të rëndësishme financiare të drejtimit dhe operacionale si dhe në tërësi e gjithë veprimtaria e fakulteteve dhe rektoratit të UMT-së janë në pajtueshmëri me politikat, kuadrin ligjor të përcaktuar si dhe procedurat dhe rregulloret e miratuara nga drejtimi.*

Aktiviteti i Njesisë së Auditimit në UMT është riaktivizuar në korrik të vitit 2022, me plotësimin e strukturës audituese, dhe emërimin e Përgjegjës të NJAB-së. Stafi aktual i Njesisë së Auditimit të brendshëm përfshin 1(një) Përgjegjës Sektori dhe 2(dy) specialistë, auditues të brendshëm.

Plani i Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022, miratuar me Vendim të BA-së me nr. 53 datë 27.09.2022, “Për miratimin e Planit të Veprimtarisë së Auditimit...”, parashikoi kryerjen e dy auditimeve të përputhshmërisë:

1. Fakulteti i Mjekësisë, Auditimi i sistemit të pagesave për periudhën 1 Janar 2018 deri më 31 Dhjetor 2019;
2. Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Auditimi i sistemit të pagesave për periudhën 1 Janar 2018 deri më 31 dhjetor 2019;

Nga auditimet u raportuan problematika, të cilat ndikuan dhe në mosrealizimin e Planit të miratuar, duke sjellë që veprimtaria e auditimit të mos arrijë objektivat për vitin 2022. Në këtë mos realizim kanë ndikuar dhe problematika të trashëguara nga periudha e kaluar, ku Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMT nuk ka hartuar Planin Strategjik 2022-2024, Planin Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm 2022, Raportin e Veprimtarisë të vitit 2021 dhe prej muajit gusht 2021 deri më korrik 2022 nuk ka kryer asnjë veprimtari audituese.

Të dy angazhimet e auditimit të parashikuara në Planin Vjetor janë ndërprerë për arsye se nga një auditues i brendshëm janë paraqitur gjetje të cilat në gjykimin e tij përmbajnë elementë të parregullsive dhe veprës penale.

Këto raste janë referuar tek Titullari, Bordi Administrimit të UMT-së dhe janë në ndjekje nga ky organ.

II. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMT-të , krahas kuadrit ligjor të përgjithshëm që rregullon veprimtrainë e institucioneve të arsimit të lartë publik, i është përmbajtur parimeve, drejtimeve si dhe objektit të auditimit të brendshëm të përcaktuar në ligjin nr. 114/2015 , datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm, në standartet ndërkombëtare të auditimit si dhe në kërkesat e parashikuara në aktet ligjore të mëposhtme të cilat përfshijnë :

- Ligji 80/2015, datë 22.07.2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*” si dhe akte normative të dala në zbatim të këtij ligji.
- Statuti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.11, datë 11.02.2019.
- Rregullore e Brendshme e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, miratuar me Vendim nr. 59, datë 27.06.2022.
- Rregullore e brendshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin në UMT, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT nr.16, datë 25.02.2020 dhe Vendim të Senatit Akademik nr. 22, datë 17.03.2020.
- Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”
- VKM nr.83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar me VKM nr.353, datë 11.05.2016
- VKM nr.116, datë 17.02.2016 “*Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimi I tarifave të trajnimit*”

- VKM nr.160, datë 02.03.2016 *“Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike”*
- Urdhër i Ministrit të Financave nr.86, datë 10.12.2015 *“Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit të Brendshëm në sektorin publik”*
- Urdhër i Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 *“Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”*
- Urdhër i Ministrit të Financave nr.3, datë 08.01.2016 *“Për miratimin e rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik”*
- Urdhër i Ministrit të Financave nr.37, datë 16.03.2016 *“Për miratimin e rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”*, i ndryshuar me Urdhër nr.26, datë 21.03.2017
- Urdhër i Ministrit të Financave nr.22, datë 06.03.2017 *“Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”*
- Urdhër i Ministrit të Financave nr.40, datë 08.05.2017 *“Për Publikimin e standardeve ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik të pranuar për zbatim në Republikën e Shqipërisë”*
- Udhëzimi Nr.42, datë 27.10.2020 *“Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”*

Të ndryshme:

Udhëzime, Udhëzues, Urdhëresa dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të ligjeve, vendimeve, urdhërave në fuqi si dhe ato të dala nga menaxhimi i UMT-së. Krahas kuadrit ligjor të mësipërm, baza ligjore e rregullatore për auditimin e brendshëm plotësohet me paketën profesionale ndërkombëtare që përfshin kuadrin e praktikave profesionale ndërkombëtare, i cili përmban Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të

Brendshëm dhe praktikat profesionale të publikuara nga IIA (Instituti i Auditimit të Brendshëm).

III. ORGANIZIMI

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në UMT kryhet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm e krijuar në nivel “Sektori” në zbatim të kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83 datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me VKM nr.353, datë 11.05.2016

Misioni i Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm në UMT është veprimtari e pavarur që ndihmon menaxhimin e Universitetit për arritjen e objektivave të tij, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë, nëpërmjet një qasje sistematike dhe të disiplinuar.

Qëllimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm është përgjegjës për verifikimin e zbatimit efektiv të sistemit të menaxhimit të kontrollit të brendshëm, qeverisjes dhe menaxhimit të riskut në UMT duke:

- U mbështetur në evidencë objektive nëse sistemet zbatohen dhe funksionojnë efektivisht;
- Identifikimin e rasteve të parregullsive dhe papajtueshmërisë ku sistemet nuk funksionojnë sipas kuadrit ligjor e rregullator;
- Identifikimin e sistemeve që nuk përmbushin kërkesat e standarteve.

Objektivat

Objektivat e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në UMT përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Dhënien e sigurisë së arsyeshme menaxhimit të UMT-së se kontrollet e brendshme janë vendosur dhe funksionojnë me efektivitet për përmbushjen e objektivave në kohë, me kosto dhe me efikasitet.
- Identifikimin e risqeve të parregullsive dhe dhënien e rekomandimeve që synojnë përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe parandalimin e rasteve të shkeljeve dhe parregullsive .
- Prioritarizimi i fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë, për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e ngjarjeve të paparshikuara dhe që çënojnë objektivat.
- Të kryejë auditime në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të auditimit të brendshëm në Shqipëri, dhe bazuar në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikën Profesionale të fushës, Kodin e Etikës dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm.


Organizimi, përbërja dhe funksionimi i strukturës së Auditimit

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë është bazuar në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kartën dhe Kodin e Etikës për audituesit dhe ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet implementimit të Planit vjetor ku parcaktohen qartë objektivat për t'u arritur, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut. Njësia e Auditimit të Brendshëm është ngritur dhe funksionon sipas strukturës së UMT-së të miratuar me vendim Nr. 1 datë 25.04.2013 të Këshillit të Administrimit UMT-së si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83 datë

03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të ktijimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.


Pavarësia Organizative

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” organizimi i veprimtarisë së auditimit dhe linjat e raportimit janë përcaktuar në Orgamniagramën e UMT.




Organizimi brenda institucionit, paraqitet si vijon:

Bordi i Administrimit



**SEKTORI I
AUDITIMIT TË**

Organizimi brenda Njesisë së Auditimit, paraqitet si më poshtë:



Pavarësia funksionale

Njësia e auditimit të Brendshëm dhe stafi auditues i njësisë së auditimit të brendshëm janë të pavarur në planifikimin , kryerjen dhe raportimin e veprimtarisë audituese.

Statusi, detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm janë përcaktuar në Kartën e Auditimit, miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT, nr 67 datë 19.12.2022

Përgjegjësi i Njesisë së auditimit harton Planin Strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë audituese , i cili më pas miratohet nga Bordi i Administrimit.

Bordi i Administrimit miraton Raportin Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm brenda datës 15 shkurt të vitit pasadhës.

IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

ANALIZA E PROGRAMEVE TË AUDITIMIT PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Plani i Veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për vitin 2022, miratuar me Vendim të BA, nr. 53 datë 27.09.2022, parashikoi kryerjen e dy auditimeve të përputhshmërisë:

1. Fakultetin e Mjekësisë, Auditimi i sistemit të pagesave për periudhën 1 Janar 2018 deri më 31 dhjetor 2019;
2. Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Auditimi i sistemit të pagesave për periudhën 1 Janar 2018 deri më 31 dhjetor 2019;

Nga auditimet u raportuan problematika, të cilat ndikuan dhe në mosrealizimin e Planit të miratuar, duke sjellë që veprimtaria e auditimit të mos arrijë objektoivat për vitin 2022.

Në këtë mos realizim kanë ndikuar dhe problematika të trashëguara nga periudha e kaluar, ku Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMT nuk ka hartuar Planin Strategjik 2022-2024, Planin Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm 2022, Raportin e Veprimtarisë të vitit 2021 dhe prej muajitg 2021 deri më Korrik 2022 nuk ka kryer asnjë veprimtari audituese.

Dy angazhimet e auditimit në FSHMT dhe në Fakultetin e Mjekësisë raportohen në statusin “Në proces”

Mos realizimi i planit vjetor ka ardhur si rrjedhojë e situatave të cilat do të trajtohen sa vijon:

1. Prej datës 10 tetor 2022 deri më datë 04 nëntor 2022 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike u krye auditimi i sistemit të pagesave për periudhën 1 Janar 2018 deri më 31 dhjetor 2019.

Pas mbarimit të punës në terren, grupi i auditimit ka përfunduar Projekt Raportin e Angazhimit, dhe më datë 25 Nëntor 2022 e kanë dorëzuar të Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit, Projekt Raportin “Auditimi i sistemit të pagesave në FSHMT”.

Në vijim, ky Projekt-Raport është vlerësuar “Në papajtueshmëri me kërkesat e Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm si dhe përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm” për faktin që përmban gjetje të raportuara nga njëri prej audituesve, që cilësohen si : “...çështje që kërkojnë hetim më të hollësishëm nga organet e drejtësisë (Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK). Njëkohësisht, Projekt Raporti i përgatitur përmbante dhe çështje të marëdhënieve të stafit auditues me Përgjegjësin e NJAB-së, dhe në këto kushte kur është krijuar një situatë që mund të përfshijë çështje në konflikt interesi. Projekt Raporti “*Auditimi i sistemit të pagesave në FSHMT*” është dërguar te Bordi i Administrimit si organi me i lartë nga i cili varet direkt Njesia e Auditimit të Brendshëm.

2. Prej dates 21 nëntor 2022 deri më datë 16 dhjetor 2022 në Fakultetin e Mjekësisë u krye auditimi i sistemit të pagesave për periudhën 1 Janar 2018 deri më 31 dhjetor 2019.

Pas përfundimit të punës në terren, grupi i auditimit ka hartuar Projekt Raportin “*Auditimi i sistemit të pagesave në FM*” dhe më datë 29 dhjetor 2022 e kanë dorëzuar tek Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit i cili më pas është dërguar për komente dhe kundërshti në njësinë e audituar në Fakultetin e Mjekësisë. Raporti Final i Auditimit të Sistemit të Pagesave në FM, në pjesë të caktuara është në papajtueshmëri me kërkesat e Standardeve dhe Manualit të Auditimit, por për shkak se në këtë raport paraqiten një

numër shumë i madh gjetjesh të cilat sipas gjykimit të audituesit kanë nevojë për investigim të mëtejshëm, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 14 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm”, Ligit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i është përcjellë Bordit të Administrimit si Titullar i njesisë publike.

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Plani Vjetor i Veprimtarisë Auditimit në UMT, identifikoi dhe vendosi si prioritetet sistemet me risk të lartë në UMT dhe gjithë universin e Auditimit, Rektoratin, dhe 3 njësitë e tjera organizative , fakultete.

Mbështetur në vlerësimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm në këtë njësi, Sistemet kryesore të kontrollit, me risk të lartë janë vlerësuar sistemi i pagesave në Rektoratin e UMT-së dhe në çdo fakultet i cili përfshin dhe nënsistemet të rëndësishme të tilla si :

- a. Prokurimet publike (blerjet e vogla dhe investime);
- b. Sistemi administrimit aktiveve;
- c. Sistemi i pagave;

Krahas materialitetit që paraqesin këto sisteme, një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e riskut ka qenë dhe frekuenca e auditimit.

Afati më i fundit i auditimit në njësitë e vartësisë ka qenë periudha e audituar deri në fund të vitit 2017. Standartet e Auditimit të Brendshëm, përcaktojnë kërkesën që çdo sistem duhet të auditohet të paktën një herë gjatë periudhës strategjike (5 vjet) dhe po ashtu çdo sistem me risk të lartë duhet të auditohet cdo vit.

Për këtë qëllim u parashikua që për sistemin e pagesave që paraqitet me risk të lartë të mos mbetet asnjë vit i pambuluar, kjo duke marrë në konsideratë dhe burimet në dispozicion.

Gjetjet kryesore të auditimit identifikuan parregullsi në efektivitetin e shërbimeve utilitare të tilla si ujë dhe energji elektrike, mungesa të dokumentacionit në procedurat e prokurimit publik për blerjet e vogla, vonesa në pagesat për llogaritë e pagueshme ,të cilat mund të përbëjnë shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura etj.

V. REKOMANDIMET

Auditimet janë në proces, çështjet janë referuar tek Bordi i Administrimit.

VI. MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

Procedurat e sigurimit të cilësisë, përfshijnë vlerësime të brendshme në zbatim të kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm , Kapitulli 7.

Si rezultat i vlerësimit të brendshëm të cilësisë, të dy Projekt raportet e Auditimit kanë marrë vlerësim negativ nga Përgjegjësi i Grupit të Auditimit dhe Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit.

Këto materiale i kanë kaluar Bordit të Administrimit për trajtim dhe vendimmarrje

VII. ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE

Njësia e Auditimit të Brendshëm është ngritur bazuar në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të ktijimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.”

Struktura organizative përbëhet nga 3 (tre) auditues të emëruar :

- ❖ Një Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm ,
- ❖ Dy auditues të brendshëm, nga të cilët: Një auditues me përvojë pune me mbi 5 vjet përvojë pune në auditim dhe i certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, 2007- 2008 dhe një auditues me përvojë pune më pak se 5 vjet në auditim dhe i certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, 2016 -2017.

Gjatë viti 2022, në zbatim të Programit të Zhvillimit Profesional të Audituesve të brendshëm, miratuar nga Ministria e financave dhe Ekonomisë , i gjithë stafi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm ka ndjekur trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për zhvillimin e kapaciteteve dhe forcimin e aftësive profesionale prej 40 orë trajnimi.

VIII. KONKLUSIONE

Qëllimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm mbetet dhënia e sigurisë së arsyeshme për menaxhimin e njësive të audituara dhe menaxhimin të lartë të UMT-së ku, nëpërmjet vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, qeverisjes dhe menaxhimin të riskut, duke ndihmuar menaxhimin me rekomandime të dobishme për përmirësimin e sistemeve, për arritjen e objektivave, për parandalimin e parregullsive dhe shkeljeve të ligjëshmërisë,

Sistemet e kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara duket të kenë dobësi materiale dhe ndërmarrja e veprimeve korigjuese dhe zbatimit të rekoamandimeve për përmirësimin e sistemeve është një domosdoshmëri.

Performanca e Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet të përmirësohet dhe kapacitetet profesionale duhet të shtohen dhe të forcohen. Pengesat në veprimtarinë audituese nuk i shërbejnë një institucioni, por përkundrazi, dëmtojnë imazhin e tij. Falë rekomandimeve të punës audituese menaxhimi i institucionit përmirëson mangësitë të cilat ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të tij.

PRIORITETET PËR VITIN E ARDHSHËM

Gjatë vitit 2023, Njësia e Auditimit të Brendshëm do të kryejë misione auditimi mbi fusha të vlerësuara me risk të lartë në fakultete dhe Rektorat.

Një rëndësi të veçantë do të ketë ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna rast pas rasti në çdo auditim.

PËRGJEGJËSI
DRITAN MINO

ANEKSI NR.3
PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT PËR NJËSITË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia Publike		UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË					
Emri, Mbledhja e Drejtuesit të Njësise së Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe adresa e e-mail:		Dritan Mino -- dritan.mino@umed.edu.al					
Adresa e faqes së Internetit (ku gjendet i bashkëngjitur organigrama e njësise)		http://umed.edu.al/universiteti/organigramat-umt/					
Data e plotësimit (sipas protokollit)		15.02.2023					
Perioda e raportimit		2022					
Përshkrimi i pyetjeve të pyetësorit sipas kuadrit rregullator për Auditimin e Brendshëm.							
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME							
Nr.	PYETJET	REFERENCA LIGJORE	ARSYETIMI MBI VLERËSIMIN E KRYER	VLERËSIMI			
				Përputhshmëri e plotë	Përputhshmëri e pjesshme	Përputhshmëri në disa fusha	Mospërputhje e plotë
KRITERE TË PËRGJITHSHME PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM							
1	NjAB është ngritur në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm dhe aktet menjefjore.	1. Ligji nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"	po				
2	NjAB kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm dhe Manualin e Auditit të Brendshëm (MAB).	1. Ligji nr.114/2015 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB)	po				
3	Karta e Auditit të Brendshëm është hartuar, miratuar dhe plotëson kërkesat e MAB. Ky dokument përditesohet në rast të ndryshimeve të rëndësishme në kuadrin rregullator të njësise publike dhe auditimit të brendshëm.	1. Neni 4 i Ligjit nr.114/2015 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm	Vendim i Bordit të Administrimit Nr.67, date 19.12.2022 Prot. 4487/3 date 19.12.2022				

4	NjAB është e pavarur nga ana funksionale, komunikon e paraqet (Kartën, planet dhe raportet) në Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KAB) (nëse ka) dhe i miraton tek titullari i njësisë publike.	1. Ligji nr.114/2015 2. VKM 160/2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike".	po	4					
5	NjAB është e pavarur nga ana funksionale, si dhe komunikon e raportton drejtpërdrejt tek Titullari i Njesisë Publike.	1. Ligji nr.114/2015 2. Organigrami e njësisë publike	po	4					
6	Audituesit e Brendshëm kanë akses të pakufizuar në dokumentacion, mjete dhe punonjës.	1. Neni 15 i Ligjit nr.114/2015	po						
7	Audituesit e Brendshëm janë të përfshirë në veprimtari të tjera operationale përveç auditimit të brendshëm.	1. Neni 17 i Ligjit nr.114/2015	jo						
8	Drejtuessi i NjAB ndërmerr një proces të përshtatshëm të shqyrtimit të konflikteve të mundshme të interesit	1. Neni 18 i Ligjit nr.114/2015	PO						
STRUKTURA ORGANIZATIVE E NJAB DHE KUALIFIKIMET E AUDITUESVE TË BRENDSHËM									
1. VKM nr.83/2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të auditimit të brendshëm në sektorin publik"									
9	Struktura e NJAB respekton kërkesat ligjore (minimumi 1 Drejtues dhe 2 specialistë të auditimit të brendshëm).	2. Organigrami e njësisë publike	Struktura 1+2						
10	Drejtuessi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë emëruar në përputhje me kriteret e punësimit të përcaktuar në kuadrin rregullator	1. Neni 11 i ligjit nr.114/2015 2. Ligji nr.152/2013 3. Kodi i Punës	po						
11	NjAB përmbush kërkesat ligjore për trajnimin e vijueshëm profesional.	1. Neni 20 i ligjit 114/2015	po						
12	Veprimtaria e audituesve të NJAB është në përputhje me Kodin e Etikës së Audituesve të Brendshëm, të miratuar nga Ministri i Financave.	1. Urdhëri 86/2015 "Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik"	po						
PLANIFIKIMI DHE RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM									
13	Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i NJAB shqyrtohet, vlerësohet dhe miratohet nga Titullari i Njesisë Publike (Bordi i Administrimit).	1. Kapitulli III MAB 2. VKM nr.160/2016 3. Proces verbal i mbledhjes së BA	po						
	Procesi i hartimit dhe miratimit të Planit Strategjik	1. Kapitulli III i MAB	po						

14	dhe Vjetor kryhet brenda afateve të përcaktuara. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB.	2. Nr. prot. datë të planit strategjik dhe vjetor	Dërguar në DH/AB me nr. 2904/3 date 19.10.2022				
15	Objektivat e Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB janë të përcaktuara qartësisht dhe në përputhje me objektivat e Njesisë Publike.	1. Kapitulli III MAB 2. Programi Buxhetor Afatnesem i njesisë publike	po				
16	NJAB mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njesisë publike (njësi varësie dhe drejtoritë pjesë e organigramës së njesisë publike) duke i dhënë prioritet fushave / sistemeve të përzgjedhura sipas nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët).	1. Plani strategjik dhe vjetor 2. Kapitulli III i MAB) 3. Kuadri rregullator që përcakton fushat e përgjegjesisë së njesisë publike.	po				
17	Audituesit e Brendshëm përdorin metodologji të përshtatshme, si dhe marrin në konsideratë opinionin e titullarit të njesisë publike në identifikimin e riskve. Gjykimi i tyre është i pavaruar dhe paanshëm.	1. Kapitulli III i MAB 2. Regjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut të njesisë publike	po				
18	Risqet që lidhen me objektivat e njesisë publike janë identifikuar dhe vlerësuar drejt nga ana e audituesve të brendshëm.	Kapitulli III i MAB	po				
19	NJAB kontribon në hartimin e regjistrit të riskut të njesisë publike (nëpërmjet riskve të vetë NJAB-së dhe riskve të reja të identifikuara gjatë veprimtarisë audituese).	1. Ligji Nr. 10296/ 2010, i ndryshuar 2. Kapitulli III MAB	po				
20	Plani Strategjik dhe Vjetor pasqyron rezultatit e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të riskut	1. Kapitulli III MAB 2. Plani strategjik dhe vjetor	po				
21	Burimet e nevojshme të NJAB përfillojnë dhe shpërndahen në mbështetje të objektiveve.	1. Kapitulli III i MAB	po				
22	Ndryshimet në Planin Vjetor argumentohen, shqyrtohen, vlerësohen dhe miratohen nga Titullari(Bordi i Administrimit) dhe janë pjesë e dosjes. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB.	1. Kapitulli III MAB 2. VKM 160/2016 3. Proces verbal i mbledhjes së KAB 4. Nr. prot të ndryshimit të planit	po				
23	Angazhimet e auditimit kryhen sipas parashikimeve në Planin Vjetor.	1. Kapitulli IV MAB 2. Raporti vjetor i veprimtarisë	po				
24	Fushëveprimi dhe objektivat e programit të auditimit përfshijnë vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nivelin e riskut dhe komponentë të tjerë.	1. Kapitulli IV i MAB	po				

25	Programi i angazhim auditimit hartohet nga grupi i auditimit dhe miratohet nga Drejtuesi i MjAB. Ky dokument respekton formën dhe përmbajtjen sipas kërkesave të MAB.	1. Kapitulli IV i MAB	po						
26	Audituesit e brendshëm identifikojnë saktë kontrollat që minimizojnë risqet, si dhe analizojnë dhe vlerësojnë përshatshmëritë e mjaftueshmëritë e këtyre kontrolleve.	1. Kapitulli III i MAB	po						
27	Gjatë angazhimit të auditimit respektohen të gjitha fazat e përcaktuara në MAB.	1. Kapitulli IV i MAB	po						
28	Dosjet e auditimit administrojnë evidencat e përshatshme për të dokumentuar punën në zbatim të program angazhim auditimit dhe për të mbështetur gjetjet.	1. Kapitulli IV i MAB	po						
29	MjAB në rastet e konstatimit të parregullsive dhe veprimave që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepr penale, raporton menjëherë tek Titullari i njësisë publike, i cili informon strukturën e Inspektimit Financiar Publik.	1. Neni 14 të ligjit 2. Nr. prot shkresa dërguar inspektimit	po						
30	Çdo rekomandim i pasqyruar në raport është i lidhur me gjetjet.	Kapitulli IV i MAB	po						
31	Observacionet/kundërshtitë e subjektit të audituar trajtohen në raportin final dhe janë pjesë e dosjes.	Kapitulli IV i MAB	po						
32	Plani i Veprimit hartohet dhe miratohet nga Titullari i subjektit të audituar dhe dërgohet në MjAB brenda afatit të përcaktuar.	1. Neni 12 i ligjit 114/2015 2. Kapitulli IV i MAB	po						
33	MjAB ndjek një proces monitorimi të vazhdueshëm lidhur me zbatimin e rekomandimeve të adresuara në njësinë publike.	1. Neni 14 i ligjit 114/2015 2. Kapitulli IV i MAB	po						
34	Drejtuesi i MjAB paraqet analizën vjetore të veprimtarisë tek Bordi i Administrimit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatën e auditimit të brendshëm në raport me planin.	1. Kapitulli IV i MAB 2. VKM 160/2016	Po Miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit Nr.7, date 14.02.2023.						
35	Procesi i hartimit dhe miratimit të raportit vjetor kryhet brenda afatave të përcaktuara. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB.	1. Neni 14 i ligjit nr.114/2015 2. Kapitulli IV i MAB	Dërguar në DH/AB me nr. ____ date 15.02.2023						
RISHIKIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË VEPRIMTARISË AUDITUESË									
36	A ka Program të Sigurimit të Cilësisë (indikatorë të përcaktuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë).	1. Kapitulli VII i MAB	po						

37	Rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Drejtuesi i NJAB. Për NJAB me strukturë të pa plotësuar rishikimi kryhet nga Drejtuesi i një NJAB tjetër. Procesi dokumentohet.	1. Kapitulli VII i MAB	po					
38	Vlerësimet/rekomandimet e procestit të rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsideratë për përmirësimin e punës së NJAB dhe janë pjesë e dosjes së auditimit.	1. Kapitulli VII i MAB	po					
39	Drejtuesi i NJAB raporton çdo vit tek Tihullari i njesisë publike mbi rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë si pjesë e raportit vjetor.	1. Kapitulli VII i MAB 2. Raporti vjetor i veprimtarisë	po					
DOKUMENTIMI I PUNES AUDITUESHE								
40	Dosjet e përhershme/të përkohshme plotësojnë kërkesat e MAB dhe arkivohen sipas legjislaacionit në fuqi.	1. Ligji nr.9154/2003	po					

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
 NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM
 VARESIA E NJESISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM, NGA BORDI I ADMINISTRIMIT
 NUMRI I PUNONJESVE NE ORGANIK, 3

Pasqyra I

Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin 2022

Nr.	EMER MBIEMER	Pozicioni	Arsimi bazë	Niveli i diplomës	Eksperienca e punës		Zhvillimi profesional				
					Vitet e punës Gjithsej	Vitet e punës në AB	Certifikimi		Trajnimet në fushën		
							I pa certifik.	Në proces certifik	I certifikuar në vitin	Nga Inst. Kom bëtare ose Ndërkom bëtar	Publikim e në fushën e AB
a	b	1	2	3	4	5	6.1	6.2	6.3	7.1	7.2
1	Dritan Mino	Përgjegjës, III-b	Ekonomik		27	11	6.1	6.2	2011/0996	7.1	7.2
2	Kasim Metallari	Auditor, III-a	Ekonomik		36	14			2008		
3	Majlind Shkira	Auditor, III-a	Fakulteti i inxhinierise se ndertimit, Ekonomik.						2017		
4											
5											
6											
7											
8											
9											

Përgjegjesi i Njesisë së Auditimit
 Dritan Mino



UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM

Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2022

Pasqyra 2
në numër

Nr.	Subjekte të audituara nga NJAB	Gjithsej	Realizimi i angazhimeve të auditimit							Status Angazh.	
			Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Angazhime të përfunduara	Angazhime në pro...
			Shërbime të sigurisë nga të cilat:								
			A. të përputhshmëris	A. të performancës	A. të financiare	A. të tek. Informacionit	A. të kombinuara	Shërbime këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në pro...
a	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5 +3.6+3.7), ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2
1	Fakulteti i Shkencave Njeksore Teknikke	1			1					1	1
2	Fakulteti i Mjekësisë	1			1					1	1
3											
4											
Totali			2	0	0	2	0	0	0	2	2

Përgjegjesi i Njesisë së Auditimit
Dritan Mino



NJESIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM NE UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË

Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit për vitin 2022

Pasqyra 3

Nr.	Subjekti i audituar	GJETJET SIPAS FUSHES OSE SISTEMIT										Shuma e dëmit ekonomik	
		2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.10		
a	1												3
1	Fakulteti i Shkencave Njësore Teknike												0.00
2	Fakulteti i Mjekësisë												0.00
3													0.00
4													0.00
5													0.00
6													0.00
7													0.00
8													0.00
9													0.00
10													0.00
11													0.00
	SHUMUA	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

000/lekë

Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit

Driftan Mino



Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2022

Nr.	Rekomandimet e dhëna sipas prioritetit	Subjekte të audituara	Statusi i rekom. të dhënë vitin e mëparshëm	STATUSI I REKOMANDIMEVE				
				Rekom. i dhënë	Rekom. i pranuar nga menaxh.	Rekom. i zbatuar	Në proces zbatimi	Arsyeja e mos zbatimit
a	1	2	3	4.1.	4.2.	4.3.	4.4.	4.5.
I	Rekomandime të përmirësimit të sistemeve							
1		Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike		0				
		Fakulteti i Mjekësisë		0				
I.1.	Në fushën e hartimit të PBA dhe projekt buxheteve vjetore si dhe të ndjekjes e zbatimit të buxhetit							
I.2	Në ndjekjen dhe zbatimin i detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme.							
I.3.	Në fushën e administrimit të aktiveve, pronave, etj.							
I.4.	Në sistemin e pagesave							
	Në fushën e pagesave për paga të punonjësve							
	Në fushën e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare							
I/I	Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor							
	SHUMA I			0	0	0	0	
II	Rekomandime të karakterit organizativ							
	Në fushën e pagesave (arkë, bankë)							
	Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe trajtimeve të tjera financiare.							
	Në fushën e zbatimit dhe pagesave të kontratave							
	Procedurat e blerjeve me sistemin dinamik (Bileta transporti ajror)							
	Në fushën e administrimit dhe menaxhimit të aktiveve materiale							
	Për regjistrimin e aktiveve							
	Për shkarkimin e aktiveve							

	Për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve							
	Për inventarizimin e aktiveve							
	Për qarkullimin pa pagesë të aktiveve							
	Në ndjekjen dhe zbatimin e kontratave							
III	Rekomandime për arkëtim dëmi							
	Në zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme							
	Në fushën e pagesave, pagave, shpërblimeve dhe trajtimeve të tjera financiare.							
	Në fushën e menaxhimit dhe administrimit të aktiveve.							
	Në ndjekjen dhe zbatimin e kontratave							
	SHUMA III			0	0		0	
IV	Rekomandime të tjera							
	SHUMA IV			0	0		0	
	TOTALI (Shuma I+ Shuma II+Shuma III+shuma IV)			0	0		0	

Përgjegjesi i Njesisë së Auditimit
Dritan Mino





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 505 / Prot.
11

Tiranë, më 15.02.2023

Lënda: Ju përcjellim Raportin e Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në UMT për vitin 2022

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË HARMONIZIMIT KONTROLLIT TË
BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK**

DREJTORISË SË HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Të nderuar,

Bazuar në ligjin nr.114, neni 14 pika ç, datë 23.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm, kapitulli III, Standardi nr. 2060, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë ka përgatitur Raportin e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në UMT, për vitin 2022.

Bashkëlidhur gjeni Ju lutem, Raportin e Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në UMT, për vitin 2022, pasqyrat dhe pyetëtorin e vetvlerësimit si dhe Vendimin e Bordit të Administrimit të UMT-së, nr. 7, datë 14.02.2023 “Për miratimin e Raportit Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm 2022, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

Duke Ju falënderuar,

REKTORI

ARBEN GJATA